



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr. 61**

**5 qershor**

**2012**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 51/2012 datë 10.5.2012	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë për ndihmë të ndërsjellë në rast të fatkeqësive dhe aksidenteve të mëdha.....	2995
Ligj nr. 52/2012 datë 10.5.2012	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë për njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit.....	3001
Ligj nr. 54/2012 datë 10.5.2012	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar.....	3008
Ligj nr. 55/2012 datë 10.5.2012	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar.....	3017
Rezolutë e Kuvendit datë 10.5. 2012	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2011.....	3019
Rezolutë e Kuvendit datë 17.5.2012	Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë (ERE) për vitin 2011.....	3020
Urdhër i MBUMK nr. 177, datë 4.6.2012	Mbi zbatimin e urdhrin nr. 328, datë 22.11.2011 dhe të urdhrin nr. 5, datë 9.1.2012 të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi certifikatat veterinare.....	3022

**LIGJ**  
**Nr. 51/2012**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KROACISË PËR  
NDIHMË TË NDËRSJELLË NË RAST TË FATKEQËSIVE DHE AKSIDENTEVE TË MËDHA**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë për ndihmë të ndërsjellë në rast të fatkeqësive dhe aksidenteve të mëdha.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 10.5.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7492, datë 24.5.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË  
REPUBLIKËS SË KROACISË PËR NDIHMË RECIPROKE, NË RAST TË FATKEQËSIVE DHE  
AKSIDENTEVE TË MËDHA**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kroacisë (më poshtë referuar si palë kontraktuese),

*të bindur* për domosdoshmërinë e bashkëpunimit mes dy vendeve, me qëllim për të lehtësuar ndihmën e ndërsjellë në rast të fatkeqësive apo aksidenteve të mëdha,  
bien dakord si vijon

Neni 1

**Qëllimi i marrëveshjes**

Kjo marrëveshje rregullon kushtet për ndihmë vullnetare në rast të fatkeqësive apo aksidenteve të mëdha, e cila sigurohet me kërkesën komunikuar nëpërmjet kanaleve diplomatike ose me kërkesën e autoriteteve kompetente të palëve kontraktuese referuar paragrafit 1 të nenit 3 të kësaj marrëveshjeje, duke dërguar ekipet e ndihmës, individë të dërguar për ndihmë ose duke ofruar materiale apo informacione për ndihmë.



## Neni 2 Përkufizime

Për qëllimet e kësaj marrëveshjeje:

“Fatkeqësi ose aksident i madh” do të thotë një ngjarje që ka ndodhur tashmë ose është e afërt, pjesërisht ose plotësisht jashtë kontrollit, e kufizuar në kohë dhe hapësirë, dhe që del nga operimi i godinave teknike, forcave destruktive natyrore ose nga trajtimi apo transportimi i materialeve të rrezikshme dhe të cilat mund të rrezikojnë jetën apo shëndetin e njerëzve ose kafshëve, paraqesin një kërcënim për mjedisin dhe pronën dhe mund të çojë në humbje të konsiderueshme ekonomike ose dëmtim të mjedisit dhe tejkalon kapacitetin përballues të palës kontraktuese të prekur.

“Shteti pritës” do të thotë pala kontraktuese, autoritetet kompetente të së cilës referuar nenit 3 paragrafi 1 të marrëveshjes ka kërkuar ndihmën e palës tjetër kontraktuese.

“Shteti dërgues” do të thotë pala kontraktuese, autoritetet kompetente të së cilës referuar nenit 3 paragrafi 1 të marrëveshjes i përgjigjet kërkesës së palës tjetër kontraktuese për ndihmë.

“Pajisje” do të thotë materialet, pajisjet teknike në veçanti, mjetet e transportit dhe qentë e shpëtimit dhe mallrat për përdorim personal.

“Materialet e ndihmës” do të thotë burimet e destinuara për shpërndarjen falas te popullata e prekur në territorin e shtetit pritës.

“Ekipet e ndihmës” do të thotë njësi e specializuar civile ose ushtarake të pajisura me pajisje të përshtatshme dhe materiale të ndihmës të përcaktuara nga shteti dërgues.

“Individët e dërguar për të ofruar ndihmë” do të thotë një ose më shumë persona të pajisur me pajisje të duhura dhe materiale të ndihmës të përcaktuara nga shteti dërgues.

## Neni 3 Autoritetet kompetente

1. Pavarësisht nga dërgimi i kërkesës për ndihmë nëpërmjet kanaleve diplomatike në pajtim me nenin 1 të kësaj marrëveshjeje, dërgimi dhe pranimi i kërkesës për ndihmë, si dhe llojet e tjera të bashkëpunimit, sipas kësaj marrëveshjeje, do të vendosen nga autoritetet e mëposhtme:

- Për Republikën e Shqipërisë: Ministria e Brendshme;
- Për Republikën e Kroacisë: Mbrojtja Kombëtare dhe Drejtoria e Shpëtimit.

2. Palët kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike për adresat dhe numrat e telekomunikacionit të autoriteteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni, si dhe pikat e kontaktit të tyre. Pikat e kontaktit do të jenë në dispozicion në çdo kohë.

3. Autoritetet e palëve kontraktuese referuar në paragrafin 1 të këtij neni do të jenë të autorizuar për të marrë kontakt të drejtpërdrejtë në zbatim të kësaj marrëveshjeje.

4. Palët kontraktuese duhet menjëherë dhe pa vonesë të informojnë njëra-tjetrën për çdo ndryshim lidhur me kompetencën e autoriteteve referuar në paragrafin 1 të këtij neni.

## Neni 4 Lloji dhe qëllimi i ndihmës

1. Ndihma mund të ofrohet me përgjigjen e ekipeve apo individëve dërguar për të ofruar ndihmë, me dërgimin e materialeve të ndihmës ose në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme, ku mbi llojin dhe qëllimin e ndihmës do të bihet dakord nga autoritetet e referuara në nenin 3, paragrafi 1 të kësaj marrëveshjeje gjatë operacioneve të ndihmës.

2. Kërkesa për ndihmë do të paraqitet në gjuhën angleze.

3. Ekipet e ndihmave mund të përdoren për shuarje zjarri, rreziqe bërthamore dhe kimike, si dhe nga fatkeqësitë e tjera dhe aksidentet e mëdha, dhe veçanërisht për dhënien e ndihmës mjekësore, kryerjen e operacioneve të shpëtimit dhe gjetjen e viktimave dhe kryerjen e operacioneve të tjera të ndihmës. Këto ekipe duhet të jenë të trajnuara siç duhet dhe të kenë pajisjet e nevojshme.

4. Transporti i ekipeve të ndihmave apo individëve të dërguar të japin ndihmë, transporti i pajisjeve dhe materialeve të ndihmës mund të bëhet nga toka, ajri dhe uji.

#### Neni 5

#### **Kalimi i kufirit shtetëror dhe qëndrimi**

1. Me qëllim lehtësimin e ndihmës së shpejtë dhe efikase, palët kontraktuese do të zvogëlojnë formalitetet e kontrollit kufitar në minimumin absolut.

2. Derisa janë të angazhuar në operacionet e ndihmës, anëtarët e ekipit të ndihmës mund të qëndrojnë në territorin e shtetit pritës pa leje pune dhe leje qëndrimi, ndërsa formalitetet e kalimit kufitar mbahen në minimum në përputhje me legjislacionin e shtetit pritës.

Udhëheqësi i ekipit ndihmues duhet të paraqesë sipas kërkesës një dokument që dëshmon pozitën e tij dhe detyrën ndihmëse, si dhe një listë të anëtarëve të ekipit të ndihmës ku të dyja dokumentet do të jenë në gjuhën e shtetit pritës ose në gjuhën angleze.

3. Anëtarët e ekipit të ndihmës do të autorizohen të veshin uniforma, ndërsa qëndrojnë në territorin e shtetit pritës, në qoftë se ajo bën pjesë në pajisjet e tyre të rregullta. Ekipi i ndihmës i shtetit dërgues do të autorizohet të përdorë shenjat e veta në automjetet e saj në territorin e shtetit pritës.

#### Neni 6

#### **Transporti i pajisjeve dhe materialeve të ndihmës përmes kufirit shtetëror**

1. Palët kontraktuese do të lehtësojnë importin dhe eksportin e pajisjeve dhe materialeve të ndihmës.

2. Udhëheqësit të ekipit të ndihmës do t'i kërkohej që të paraqesë në autoritetet e kontrollit kufitar dhe doganor të shtetit pritës në momentin e hyrjes në territorin e saj, vetëm një listë të pajisjeve dhe të materialeve të ndihmës që do të merren përtej kufirit shtetëror, në gjuhën e shtetit pritës ose në gjuhën angleze.

3. Anëtarët e ekipit të ndihmës ose individët e dërguar për dhënien e ndihmës nuk duhet të mbajnë mallra të tjera, përveç pajisjeve dhe materialeve të ndihmës. Ata nuk do të sjellin as armë, e as municione të territorin e shtetit pritës.

4. Kufizimet ose ndalimet e aplikueshme për trafikun ndërkufitar të mallrave nuk duhet të zbatohen për pajisjet dhe materialet e ndihmës. Nëse pajisjet dhe materialet e ndihmës janë konsumuar apo shkatërruar, ato do të merren nga shteti pritës. Pajisjet e lëna prapa si materiale të ndihmës do të specifikohen si për llojin dhe sasinë e tij dhe raportohen tek autoriteti kompetent i shtetit pritës referuar në paragrafin 1 të nenit 3 të kësaj marrëveshjeje, të cilët duhet të njoftojnë autoritetin doganor mbi këtë.

5. Dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni do të zbatohen edhe për importin e lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope në shtetin pritës dhe për kthimin e sasisë së pashfrytëzuar të këtyre substancave në shtetin dërgues. Ky trafik i mallrave nuk konsiderohet si import dhe eksport në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtare mbi lëndët narkotike dhe substancat psikotrope. Lëndët narkotike dhe substancat psikotrope mund të merren vetëm për nevojat emergjente mjekësore dhe mund të jenë të administruara për qëllime mjekësore dhe vetëm nga personeli i kualifikuar mjekësor në përputhje me rregullat ligjore të palës kontraktuese së cilës i përket ekipi i ndihmës ose individ i dërguar për dhënien e ndihmës. Sasia e lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope e përdorur do të regjistrohet në statistikat e shtetit dërgues mbi konsumin e tyre.

6. Palët kontraktuese mbi parimin e reciprocitetit do të lejojnë që importi i përkohshëm i pajisjeve të bëhet pa pagesë. Këto pajisje, si dhe materialet e ndihmës do të përjashtohen nga detyrimet doganore në import dhe taksat apo tarifat e tjera të aplikueshme.



#### Neni 7

##### **Përdorimi i avionëve**

1. Avionët mund të përdoren për zhvendosjen e shpejtë të ekipeve të ndihmave, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 4 të kësaj marrëveshjeje, si dhe për llojet e tjera të ndihmës direkte.
2. Palët kontraktuese do të bien dakord që avionët e përdorur në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni të ngrihen nga territori i palës tjetër kontraktuese, mund të fluturojnë mbi territorin e saj dhe të ngrihen e të ulen edhe jashtë aeroporteve ndërkombëtare dhe pistave të regjistruara të ngritjes dhe uljes së avionëve.
3. Për përdorimin e avionëve gjatë operacioneve të ndihmës duhet të raportohet pa vonesë tek autoritetet kompetente të kontrollit të trafikut ajror referuar kësaj marrëveshjeje dhe të jepen detaje të sakta lidhur me llojin dhe numrin e regjistrimit të avionit, ekuipazhin e saj, mallrat, kohën e ngritjes, rrugën e fluturimit dhe vendin e uljes.
4. Për këtë qëllim:
  - a) Neni 5 i kësaj marrëveshjeje do të aplikohet për ekuipazhin e avionëve dhe anëtarëve të ekipeve të ndihmave transportuar me avion;
  - b) Neni 6 i kësaj marrëveshjeje do të zbatohet për avionët dhe pajisjet e tjera dhe materialet e ndihmës në avion.
5. Përveç kur përcaktohet ndryshe në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, do të aplikohen rregullat e trafikut ajror të palëve kontraktuese.
6. Përdorimi i avionëve ushtarakë i nënshtrohet miratimit të shtetit pritës.

#### Neni 8

##### **Koordinimi dhe menaxhimi i operacioneve të ndihmës**

1. Bashkërendimi dhe menaxhimi i operacioneve të shpëtimit dhe ndihmës është përgjegjësi e autoriteteve të shtetit pritës.
2. Urdhrat për ekipet e ndihmave të shtetit dërgues i jepen ekskluzivisht komandantëve, të cilët pastaj do të udhëzojnë anëtarët e ekipit të tyre në përputhje me rrethanat.
3. Autoritetet e shtetit pritës duhet, brenda fushëveprimit të kompetencave të tyre, të sigurojnë mbrojtje dhe ndihmën e nevojshme për ekipet e ndihmës të shtetit dërgues ose individët e dërguar për të ofruar ndihmë.

#### Neni 9

##### **Kostot e operacioneve**

1. Shteti dërgues nuk ka të drejtë për kompensim të shpenzimeve të ndihmës nga ana e shtetit pritës. Kjo vlen edhe për shpenzimet që lindin nëpërmjet përdorimit, dëmtimit ose humbjes së pajisjeve.
2. Paragrafi 1 i këtij neni nuk zbatohet nëse shpenzimet e ndihmës janë kompensuar plotësisht ose pjesërisht. Shteti dërgues do të ketë përparësi në kompensim.
3. Shteti pritës do të përballojë shpenzimet e operacioneve të ndihmës kryer në bazë të kërkesës së saj nga personat fizikë ose juridikë vënë në dispozicion nga ndërmjetësimi i shtetit dërgues.
4. Gjatë kohëzgjatjes së operacionit në shtetin pritës, shteti pritës si të jetë e përshtatshme dhe me shpenzimet e tij, do të sigurojë mbështetje logjistike dhe të ndihmës së parë për ekipet e ndihmës të shtetit dërgues dhe individët e dërguar për dhënien e ndihmës.

#### Neni 10

##### **Dëmet dhe kompensimi**

1. Çdo palë kontraktuese do të heqë dorë nga ndonjë pretendim për dëmet ndaj palës tjetër kontraktuese ose individët e saj dërguar për të dhënë ndihmë në lidhje me:

a) dëmtimin e pronës, të shkaktuar nga individë që dërgohen për të dhënë ndihmë gjatë kryerjes së detyrave të tyre;

b) dëmet si plagosje fizike, dëmtimi i shëndetit ose vdekja e një individi dërguar për të dhënë ndihmë, ndodhur gjatë kryerjes së detyrave të tij.

Kjo nuk do të zbatohet për rastet kur dëmtimi është shkaktuar me dashje ose si rezultat i neglizhencës së plotë.

2. Nëse një individ i dërguar të japë ndihmë nga shteti dërgues, i shkakton dëme një pale të tretë gjatë kryerjes së detyrave të tij në territorin e shtetit pritës, shteti pritës do të jetë përgjegjës për këtë dëmtim në përputhje me rregullat ligjore të aplikueshme në rastet kur dëmtimi i tillë është shkaktuar nga shtetasit e saj, ndërsa kryejnë detyrat e asistencës.

3. Shteti pritës nuk ka të drejtën e kompensimit nga ana e shtetit dërgues apo nga individët e dërguar nga shteti dërgues për të ofruar ndihmë. Nëse një individ i dërguar nga ana e shtetit dërgues për të ofruar ndihmë i shkakton dëme një pale të tretë me qëllim apo si rezultat i neglizhencës së plotë, atëherë shteti pritës mund të ushtrojë të drejtën e tij për të kërkuar dëmshpërblim nga pala dërguese.

4. Palët kontraktuese do të bashkëpunojnë ngushtësisht në përputhje me legjislacionet e tyre respektive kombëtare me qëllim për të lehtësuar ushtrimin e të drejtave për të kërkuar dëmshpërblim dhe kompensim. Palët kontraktuese do të shkëmbejnë në mënyrë të veçantë të gjithë informacionin në dispozicion për të gjitha rastet e dëmeve për qëllimet e këtij neni.

#### Neni 11 **Telekomunikimet**

Autoritet e referuara në paragrafin 1 të nenit 3 të marrëveshjes do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar telekomunikim të besueshëm për nevojat e ekipeve të ndihmave, në vendin e operacioneve.

#### Neni 12 **Përfundimi i operacioneve të ndihmave**

Ekipet e ndihmës apo individët e dërguar për të ofruar ndihmë do të ndërpresin aktivitetet e tyre, kur shteti pritës udhëzon këtë, përndryshe do të pushojnë aktivitetin e tyre pas përfundimit të detyrave.

#### Neni 13 **Format e mëtejshme të bashkëpunimit**

1. Palët kontraktuese do të bashkëpunojnë më përputhje me legjislacionet e tyre respektive kombëtare dhe veçanërisht:

a) me qëllim parandalimin dhe zbutjen e fatkeqësive ose aksidenteve të mëdha nëpërmjet shkëmbimit të të dhënave shkencore dhe organizimit të takimeve, programeve kërkimore, seminareve të ekspertëve dhe stërvitjeve për operacionet e ndihmës në territoret respektive të palëve kontraktuese;

b) me qëllim shkëmbimin e informacionit mbi rreziqet dhe dëmet që mund të lindin dhe të ndikojnë në territorin e palës tjetër kontraktuese. Shkëmbimi i ndërsjellë i informacionit gjithashtu përfshin transferimin e vlerave të matshme të përcaktuara.

2. Dispozitat përkatëse të kësaj marrëveshjeje do të zbatohen edhe për bashkëpunimin në fushën e trajnimit dhe stërvitjet e përbashkëta sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3. Bashkëpunimi në fushën e arsimit mund të kryhet veçanërisht:

a) në formën e takimeve të ekspertëve;

b) nëpërmjet pjesëmarrjes në seminare të ekspertëve.

4. Shpenzimet e kryera në kuadrin e bashkëpunimit në fushën e arsimit do të llogariten si vijon:

a) Pala kontraktuese që dërgon pjesëmarrës do të mbulojë shpenzimet e tyre të udhëtimit, si dhe shpenzimet për kthimin e tyre në rast sëmundjeje apo vdekjeje;



b) Pala kontraktuese që zhvillon takimin e ekspertëve referuar paragrafit 3 të këtij neni do të mbulojë shpenzimet e akomodimit dhe të ushqimit, si dhe shpenzimet për kujdesin mjekësor të ndihmës së shpejtë.

#### Neni 14

#### **Komiteti i Përbashkët i Përhershëm**

1. Për qëllime të zbatimit të kësaj marrëveshjeje, palët kontraktuese do të ngrenë një Komitet të Përbashkët të Përhershëm që do të përbëhet nga përfaqësues të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kroacisë. Të dyja palët kontraktuese do të kenë numër të njëjtë të anëtarëve të Komitetit të Përbashkët të Përhershëm, por jo më pak se tre. Palët kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën mbi personat e emëruar bashkëkryetarë të Komitetit të Përbashkët të Përhershëm nëpërmjet kanaleve diplomatike.

2. Detyrat e Komitetit të Përbashkët të Përhershëm do të jenë:

- Të organizojë aktivitetet që rrjedhin nga kjo marrëveshje dhe të zgjidhë problemet specifike teknike në lidhje me këtë marrëveshje;

- Të përcaktojë mënyrat e mbajtjes së kontakteve dhe të informacioneve të ndërsjella;

- Të hartojë rregullat e procedurës.

3. Komiteti i Përbashkët i Përhershëm mundet, sipas nevojës, të ngrejë një nënkomitet me profilin e duhur për zbatimin e detyrave të veçanta që mbulohen nga bashkëpunimi, ku ndihma e ekspertëve të tjerë mund të përdoret për këtë qëllim.

4. Komitetit të Përbashkët të Përhershëm do të takohet sipas nevojës, së paku, një herë në dy vjet, duke u alternuar në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kroacisë.

#### Neni 15

#### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga zbatimi ose interpretimi i kësaj marrëveshjeje, të cilat nuk mund të zgjidhen direkt nga autoritetet e referuara në paragrafin 1 të nenit 3 të kësaj marrëveshjeje, do të zgjidhen nëpërmjet kanaleve diplomatike.

#### Neni 16

#### **Lidhja me marrëveshjet e tjera ndërkombëtare**

Kjo marrëveshje nuk do të ndikojë në detyrimet përkatëse të palëve kontraktuese që rrjedhin nga marrëveshjet e tjera ndërkombëtare në të cilat ato janë lidhur.

#### Neni 17

#### **Dispozitat përfundimtare**

1. Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohore.

2. Kjo marrëveshje do të zbatohet përkohësisht që nga data e nënshkrimit të saj dhe do të hyjë në fuqi datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me anë të së cilës palët kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike që kërkesat përkatëse të tyre ligjore për hyrjen e kësaj marrëveshjeje në fuqi janë plotësuar.

3. Kjo marrëveshje mund të përfundojë me anë të njoftimit me shkrim në çdo kohë nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në këtë rast, kjo marrëveshje do të përfundojë pas gjashtë muajsh nga data në të cilën pala kontraktuese ka marrë njoftimin e përfundimit të saj.

Nënshkruar në Dubrovnik më 7 tetor 2011 në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, kroate dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëllorj autentike. Në rast keqkuptimi mbi interpretimin, teksti në anglisht do të ketë epërsi.

**LIGJ**  
**Nr. 52/2012**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KROACISË PËR  
NJOHJEN E NDËRSJELLË TË LEJEVE TË DREJTIMIT**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë për njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 10.5.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7493, datë 24.5.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**MARRËVESHJE**

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË  
REPUBLIKËS SË KROACISË MBI NJOHJEN E NDËRSJELLË TË LEJEVE TË DREJTIMIT**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kroacisë (në vijim të quajtura “palë kontraktuese”),

*me qëllim* përmirësimin e sigurisë rrugore, si dhe lehtësimin e qarkullimit rrugor në territoret e Palëve Kontraktuese,

kanë rënë dakord për sa më poshtë

Neni 1

Palët kontraktuese njohin reciprokisht konvertimin e lejeve të rregullta të drejtimit të lëshuara nga autoritetet kompetente të palës tjetër kontraktuese, në pajtim me legjislacionin e tyre të brendshëm, në favor të mbajtësve të lejeve të drejtimit të cilëve u është dhënë leja e qëndrimit ose e qëndrimit të përkohshëm në territoret e tyre.

Palët kontraktuese njohin gjithashtu për qëllime qarkullimi në territoret e tyre lejet kombëtare të drejtimit të lëshuara nga pala tjetër kontraktuese brenda periudhës së vlefshmërisë së tyre.





## Neni 2

Leja e drejtimit e lëshuar nga një prej autoriteteve të palëve kontraktuese, pushon së qenuri e vlefshme për qëllim qarkullimi në territorin e palës tjetër kontraktuese, pas një viti nga data e dhënies së lejes së qëndrimit ose qëndrimit të përkohshëm mbajtësit të saj në territorin e palës tjetër kontraktuese.

## Neni 3

Në interpretim të neneve të kësaj marrëveshjeje, termi “qëndrim” dhe “qëndrim i përkohshëm” ka kuptimin e përcaktuar dhe rregulluar nga kuadri përkatës ligjor në fuqi i palëve kontraktuese.

## Neni 4

Nëse një mbajtës i lejeve të drejtimit të lëshuara nga një prej autoriteteve të palëve kontraktuese i është dhënë leja e qëndrimit ose qëndrimit të përkohshëm në territorin e palës tjetër kontraktuese, ata konvertojnë lejet e tyre të drejtimit pa iu nënshtuar provimeve teorike dhe praktike.

Autoritetet kompetente kërkojnë një certifikatë mjekësore, e cila vërteton se një person ka kaluar provimin e cilësive psikofizike, të kërkuara për kategorinë specifike.

Për zbatimin e paragrafit të parë të këtij neni, mbajtësi i lejes së drejtimit duhet të ketë moshën e parashikuar nga legjislacionet e brendshme përkatëse të palëve kontraktuese për lëshimin e kategorisë për të cilën kërkon konvertimin.

## Neni 5

Konvertimi i lejeve të drejtimit të Republikës së Shqipërisë të hartuara sipas modelit prej letre në fuqi që nga 1 nëntori 1999, do të lejohet për periudhën prej një viti pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje. Për këto leje drejtimi është e nevojshme që në çdo rast të kërkohet një certifikatë, e përmendur në nenin 8 të marrëveshjes, e cila provon vlefshmërinë e tyre.

## Neni 6

Në kohën e konvertimit të lejeve të drejtimit, kategoritë e barazvlefshme të lejeve të drejtimit të palëve kontraktuese njihen në bazë të tabelave teknike të barazvlefshmërisë, që i bashkëlidhen kësaj marrëveshjeje, pjesë përbërëse të së cilës ato janë. Këto tabela dhe një listë e modeleve të lejeve të drejtimit përbëjnë shtojcat teknike që mund të ndryshohen me anë të një njoftimi me shkrim ndërmjet autoriteteve kompetente të palëve kontraktuese.

Autoritetet qendrore kompetente për konvertimin dhe verifikimin e lejeve të drejtimit janë si më poshtë:

- a) në Republikën e Shqipërisë, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit – Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor;
- b) në Republikën e Kroacisë, Ministria e Brendshme – Departamenti për Çështjet e Shërbimeve Administrative.

Palët kontraktuese përdorin gjuhën angleze në zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe gjithashtu mund të bien dakord mbi përdorimin e gjuhëve të tjera për komunikim.

## Neni 7

Gjatë procedurës së konvertimit të lejeve të drejtimit, autoritetet kompetente të palëve kontraktuese tërheqin lejet që duhet të konvertohen dhe ua kthejnë ato autoriteteve kompetente të palës tjetër kontraktuese, bashkë me një listë të këtyre lejeve dhe një njoftim.

#### Neni 8

Autoriteti kompetent i secilës prej palëve kontraktuese që kryen konvertimin, kërkon përkthimin zyrtar të lejes së drejtimit. Ky autoritet u kërkon informacion autoriteteve kompetente të palës tjetër kontraktuese, në rastet kur lindin dyshime në lidhje me vlefshmërinë e lejes së drejtimit dhe të dhënave të treguara në të.

Informacioni i konvertimit kryhet nëpërmjet telefaksit, duke përdorur modelin e “Certifikatës së vlefshmërisë të lejes së drejtimit”, bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje. Kjo certifikatë përbën një shtojcë teknike që mund të ndryshohet nga autoritetet kompetente të palëve kontraktuese me anë të një njoftimi me shkrim.

Të dhënat i dërgohen drejtpërdrejt autoritetit kompetent kërkues.

#### Neni 9

Autoriteti qendror kompetent i një pale kontraktuese që merr lejen e drejtimit të tërhequr, pas konvertimit, njofton autoritetin qendror kompetent të palës tjetër kontraktuese nëse dokumenti përmban parregullsi në lidhje me vlefshmërinë dhe të dhënat e treguara në të.

#### Neni 10

Kjo marrëveshje do të zbatohet përkohësisht nga data e nënshkrimit dhe do të hyjë në fuqi gjashtëdhjetë ditë pas datës së marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me anë të të cilit palët kontraktuese kanë njoftuar njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, mbi përmbushjen e procedurave të tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Kjo marrëveshje do të ketë një kohëzgjatje prej pesë vjetësh. Secila palë kontraktuese mund ta denoncojë këtë marrëveshje me shkrim në çdo kohë me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar palës tjetër kontraktuese, nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në këtë rast, denoncimi do të hyjë në fuqi pas gjashtë muajsh nga data e marrjes së këtij njoftimi.

Çdo diskutim në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet me anë të konsultimeve dhe bisedimeve ndërmjet Palëve Kontraktuese.

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me miratim të ndërsjellë me shkrim të palëve kontraktuese. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

Bërë në Tiranë, më 23.1.2012, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, kroate dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

#### SHTOJCË

E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KROACISË MBI NJOHJEN E NDËRSJELLË TË LEJEVE TË DREJTIMIT

#### SHTOJCA 1

#### MODELET E LEJEVE TE DREJTIMIT

Modelet e lejeve të drejtimit të lëshuara në Republikën e Kroacisë

Një model prej letrë i lejes së drejtimit (ku futen kategoritë e mjeteve A, B, C, D dhe E dhe tipave të mjeteve F, G dhe H) lëshuar deri më 20 nëntor 2004. Këto leje drejtimi janë të vlefshme dhe afati i konvertimit të tyre është deri më 20 gusht 2009.

Një model prej letrë i lejes së drejtimit, ku futen kategoritë e mjeteve A1, A, B, B+E, C1, C1+E, C, C+E, D, D+E, F, G, H dhe M, lëshuar nga data 20 nëntor 2004 deri më 1 shkurt 2009. Këto leje drejtimi janë të vlefshme deri në datën e përfundimit të tyre.



Një model prej letre i lejes së drejtimit, ku futen kategoritë e mjeteve A1, A2, A, B, B+E, C1, C1+E, C, C+E, D, D+E, F, G, H dhe M, lëshuar që nga data 1 shkurt 2009.

Modelet e lejeve të drejtimit të lëshuara në Republikën e Shqipërisë

Një model prej kartoni i lejes së drejtimit të lëshuar në Shqipëri nga data 1 korrik 2005.

Një model prej letre i lejes së drejtimit, i vlefshëm nga data 1 nëntor 1999 dhe që mund të konvertohet në Republikën e Kroacisë një vit nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

## SHTOJCA 2 TABELAT E EKUIVALENCËS

I. Për konvertimin e lejeve të drejtimit të lëshuara në Republikën e Shqipërisë deri në 1 korrik 2005 me leje drejtimi kroate

Leje drejtimi shqiptare	Leje drejtimi kroate														
	A1	A2	A	B	B+E	C1	C1+E	C	C+E	D	D+E	F	G	H	M
A	X	X	X									X	X		X
B				X								X	X		X
C				X		X		X				X	X		X
D				X		X		X		X		X	X		X
E					X*		X*		X*		X*				
F												X	X		X

\* Përzgjedhja e kombinimit të kategorive varet se në cilën prej kategorive, me përjashtim të E-së, është lëshuar leja e drejtimit shqiptare.

II. Për konvertimin e lejeve të drejtimit të lëshuara në Republikën e Shqipërisë nga data 1 korrik 2005 me leje drejtimi kroate

Leje drejtimi shqiptare	Leje drejtimi kroate														
	A1	A2	A	B	B+E	C1	C1+E	C	C+E	D	D+E	F	G	H	M
A	X	X	X									X	X		X
B				X								X	X		X
C				X		X		X				X	X		X
D				X		X		X		X		X	X		X
BE				X	X							X	X		X
CE				X	X	X	X	X	X			X	X		X
DE				X	X	X	X	X	X	X	X	X	X		X

III. Për konvertimin e lejeve të drejtimit të lëshuara në Republikën e Kroacisë deri më 20 nëntor 2004 me leje drejtimi shqiptare

Leje drejtimi kroate	Leje drejtimi shqiptare						
	A	B	C	D	BE	CE	DE
A	X						
B		X					
C		X	X				
D		X	X	X			
E					X*	X*	X*
F*							
G*							
H*							

\* Kategoria e barazvlefshme nuk ekziston.

X\* - Përzgjedhja e kombinimit të kategorive varet se në cilën prej kategorive, me përjashtim të E-së, është lëshuar leja e drejtimit kroate.

IV. Për konvertimin e lejeve të drejtimit të lëshuara në Republikën e Kroacisë nga data 20 nëntor 2004 deri më 1 shkurt 2009 me leje drejtimi shqiptare

Leje drejtimi kroate	Leje drejtimi shqiptare						
	A	B	C	D	BE	CE	DE
A1							
A	X						
B		X					
B+E		X			X		
C1		X					
C1+E		X			X		
C		X	X				
C+E		X	X		X	X	
D		X	X	X			
D+E		X	X	X	X	X	X
F*							
G*							
H*							
M*							

\* Kategoria e barazvlefshme nuk ekziston.

V. Për konvertimin e lejeve të drejtimit të lëshuara në Republikën e Kroacisë nga data 1 shkurt 2009 me leje drejtimi shqiptare

Leje drejtimi kroate	Leje drejtimi shqiptare						
	A	B	C	D	BE	CE	DE
A1							
A2							
A	X						



B		X					
B+E		X			X		
C1		X					
C1+E		X			X		
C		X	X				
C+E		X	X		X	X	
D		X	X	X			
D+E		X	X	X	X	X	X
F*							
G*							
H*							
M*							

\* Kategoria e barazvlefshme nuk ekziston.

#### SHËNIM

Prej 9 janarit 2012, për drejtuesit e mjeteve që kanë kaluar një test të lejes së drejtimit për mjetet e kategorisë AM, kategoria M certifikohet në lejen e tyre të drejtimit dhe për drejtuesit e mjeteve që kanë kaluar një test të lejes së drejtimit për mjetet e kategorisë D1, domethënë mjetet D1+E, kategoria D, domethënë kategoria D+E certifikohet në lejen e tyre të drejtimit. Në të njëjtën kohë teksti në vijim futet si shënim: “I vlefshëm vetëm për kategorinë D1”, domethënë teksti “I vlefshëm vetëm për kategorinë D1+E”.

Lloji në fjalë parashikohet të përdoret deri sa rregullat e reja për lejet e drejtimit të miratohen, të cilat do të paraqesin leje drejtimi stili i kartave të kreditit me një mikroçip të integruar.

#### SHTOJCA 3

Ministria e Brendshme  
Departamenti për Çështjet e Shërbimeve Administrative  
Republika e Kroacisë  
Faks: 0385 1 3788753

Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit  
Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor  
Republika e Shqipërisë  
Faks: 0035542238175

#### CERTIFIKATË VLEFSHMËRIE E LEJES SË DREJTIMIT

NR. \_\_\_\_\_

Lutemi informohuni se leja e drejtimit të automjetit me numër \_\_\_\_\_ është e rregullt dhe përmban të dhënat e mëposhtme:

#### A. Të dhëna të mbajtësit të lejes së drejtimit

- Emri: \_\_\_\_\_
- Mbiemri: \_\_\_\_\_
- Datëlindja: \_\_\_\_\_
- Vendlindja: \_\_\_\_\_
- Data e lëshimit: \_\_\_\_\_
- Data e skadimit: \_\_\_\_\_
- Numri i lejes: \_\_\_\_\_

- Kategoritë: \_\_\_\_\_  
- Adresa: \_\_\_\_\_

B. Kërkesa të tjera të detyrueshme (për shembull, syze të detyrueshme, protezë akustike etj.):

C. Leja e drejtimit është lëshuar\*/nuk është lëshuar\* nga konvertimi i një lejeje tjetër të huaj të lëshuar nga:

VENDI DHE DATA

VULA DHE FIRMA E NËPUNËSIT

(\*) Me përjashtim të rastit që nuk është i zbatueshëm.

### SHTOJCA 3

Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit  
Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor  
Republika e Shqipërisë  
Faks: 0035542238175

Ministria e Brendshme  
Departamenti për Çështjet e Shërbimeve Administrative  
Republika e Kroacisë  
Faks: 0385 1 3788753

### CERTIFIKATË VLEFSHMËRIE E LEJES SË DREJTIMIT NR. \_\_\_\_\_

Lutemi informohuni se leja e drejtimit të automjetit me numër \_\_\_\_\_ është e rregullt dhe përmban të dhënat e mëposhtme:

A. Të dhëna të mbajtësit të lejes së drejtimit

- Emri: \_\_\_\_\_  
- Mbiemri: \_\_\_\_\_  
- Datëlindja: \_\_\_\_\_  
- Vendlindja: \_\_\_\_\_  
- Data e lëshimit: \_\_\_\_\_  
- Data e skadimit: \_\_\_\_\_  
- Numri i lejes: \_\_\_\_\_  
- Kategoritë: \_\_\_\_\_  
- Adresa: \_\_\_\_\_

B. Kërkesa të tjera të detyrueshme (për shembull, syze të detyrueshme, protezë akustike, etj.):

C. Leja e drejtimit është lëshuar\*/nuk është lëshuar\* nga konvertimi i një lejeje tjetër të huaj të lëshuar nga:

VENDI DHE DATA

VULA DHE FIRMA E NËPUNËSIT

(\*) Me përjashtim të rastit që nuk është i zbatueshëm.



**LIGJ**  
**Nr. 54/2012**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9232, DATË 13.5.2004 “PËR  
PROGRAMET SOCIALE PËR STREHIMIN E BANORËVE TË ZONAVE URBANE”, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

**Neni 1**

Titulli i ligjit ndryshohet si më poshtë:  
“PËR PROGRAMET SOCIALE TË STREHIMIT”.

**Neni 2**

Në nenin 1, pika 2 ndryshohet si më poshtë:  
“2. Ky ligj e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.”.

**Neni 3**

Në nenin 2 bëhen këto ndryshime e shtesa:

1. Pika 11 ndryshohet si më poshtë:

“11. “Persona juridikë privatë” janë shoqëritë, shoqatat, fondacionet dhe entet e tjera me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga legjislacioni në fuqi.”.

2. Pas pikës 17 shtohen pikat 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26 e 27 me këtë përmbajtje:

“18. “Emigrant i rikthyer” janë kategoritë e përcaktuara në ligjin nr. 9668, datë 18.12.2006 “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”.

19. “Punëtor emigrant” janë kategoritë e përcaktuara në ligjin nr. 9555, datë 8.6.2006 “Për ratifikimin e konventës europiane “Për statusin ligjor të punëtorëve emigrantë””.

20. “Familjet e policëve të rënë në detyrë” janë të gjitha kategoritë që përfshihen në ligjin nr. 10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”.

21. “Persona me aftësi të kufizuara (PAK)” janë kategoritë që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe që përfshihen në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, në ligjin nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, të ndryshuar.

22. “Viktima të dhunës në familje” janë kategoritë e përcaktuara në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

23. “Grant i menjëhershëm” është një sasi të hollash që përfitojnë, pa të drejtë kthimi, disa kategori të specifikuara, në masën e përcaktuar në këtë ligj dhe sipas procedurës që përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

24. “Grante të vogla” janë grante konkurruese që shpallen nga ministria që mbulon strehimin, për financimin, e plotë ose të pjesshëm, të projekteve që propozohen dhe zbatohen nga organet e qeverisjes vendore, në përputhje me standardet e përcaktuara me udhëzim nga ministria, për qëllime të këtij ligji.

25. “Të ardhura familjare” janë të ardhurat periodike që siguron familja nga pagat, veprimtaria ekonomike, ndihma ekonomike dhe pagesa e papunësisë, pagesat që marrin pjesëtarët e familjes me aftësi të kufizuara dhe përfitimet e invalidëve, sipas statusit të invalidit të punës apo të luftës, interesat e depozitave bankare, të ardhura nga persona të tretë, qiratë nga prona të paluajtshme. Në këto të ardhura nuk përfshihen ato nga rimbursimi i shpenzimeve për energji, rimbursimet për ilaçe e mjekime për të sëmurët kronikë, paketa higjieno - shëndetësore për PAK-të, pagesa për kujdestarin për PAK-të, kur ky/kjo nuk është anëtar i familjes.

26. “Të ardhura mesatare” është niveli mesatar i konsumit familjar, sipas nivelit më të ulët territorial të dizagregimit të të dhënave nga INSTAT-i dhe që publikohet në mënyrë periodike.

27. “Punonjës të Policisë së Shtetit” janë kategoritë e përcaktuara në ligjin nr. 9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar.”.

#### Neni 4

Në nenin 3 pika 1 bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjat “a” dhe “b”, fjalët “organizata jofitimprurëse” zëvendësohen me fjalët “persona juridikë privatë”.

2. Në shkronjën “c”, fjalët “plani rregullues urbanistik” zëvendësohen me fjalët “plani i përgjithshëm vendor”.

#### Neni 5

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

#### “Neni 4

#### **Përcaktimi i familjeve që përfitojnë nga programet sociale të strehimit**

1. Sipas këtij ligji, përfitojnë strehim individët, që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësitë e qeverisjes vendore, të cilat, në momentin e aplikimit, plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) nuk kanë në pronësi një banesë;

b) zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike, ku bëjnë pjesë këto familje, ose banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi;

c) kanë mbetur të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore.

2. Përfshihen në njërin nga shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni vetëm ato familje, që kanë të ardhura të pamjaftueshme, sipas përcaktimeve të neneve 6 e 19 të këtij ligji.

3. Përfitojnë sipas programeve të përcaktuara në krerët III dhe IV të këtij ligji edhe shtetas të huaj, me qëndrim të rregullt në Shqipëri dhe që kanë përfituar nga organet kompetente statusin:

a) “punëtor emigrant”;

b) “azilkërkues”.

4. Administrimi i kërkesave për përfitimin nga programet sociale të strehimit dhe caktimi i përparësive bëhen nga strukturat përkatëse të organeve të qeverisjes vendore dhe miratohen me vendim të këshillave të njëjësive të qeverisjes vendore, përveç rasteve kur në ligje të veçanta përcaktohet ndryshe.





5. Dokumentacioni, që duhet të paraqesë familja për të përfituar strehim, sipas njërit prej programeve sociale të strehimit, dhe afatet e procedurat përkatëse përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Normat për përfitimin e strehimit, sipas shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

## Neni 6

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

### “Neni 5

#### **Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve**

1. Përzgjedhja e familjeve përfituese bëhet sipas një sistemi pikëzimi, me anë të të cilit vlerësohen:

a) Kushtet e strehimit, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi familjet që:

i) nuk disponojnë banesë në pronësi;

ii) banojnë në banesa që paraqesin rrezik shembjeje;

iii) banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi;

iv) kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore ose zbatimit të një vendimi gjyqësor.

b) Kushtet familjare, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi rastet e mëposhtme:

i) familjet njëprindërore, që kanë në ngarkim fëmijë;

ii) të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t’u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore;

iii) familjet me më shumë se katër fëmijë;

iv) çiftet e reja me moshë totale deri në 60 vjeç.

c) Kushtet sociale, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi rastet e mëposhtme:

i) personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave për këto kategori;

ii) personat me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore e deri në moshën 30 vjeç;

iii) emigranti i rikthyer, punëtor emigrant;

iv) familjet e policëve të rënë në detyrë;

v) viktimat e dhunës në familje.

ç) Gjendja ekonomike, në bazë të së cilës përcaktohen familjet sipas grupeve të të ardhurave.

2. Sistemi i pikëzimit miratohet me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore për çdo program që zbatohet në një njësi të qeverisjes vendore dhe bazohet në kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Kur programi zbatohet me financim, të plotë ose të pjesshëm, të Buxhetit të Shtetit, ministria, që mbulon çështjet e strehimit, në raport me masën e financimit dhe në bashkërendim dhe në marrëveshje me kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore përkatëse, mund të kushtëzojë një sistem pikëzimi, që favorizon kategori, të cilat kanë përparësi në politikat kombëtare, si personat me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore deri në moshën 30 vjeç, personat me aftësi të kufizuara, punëtorët emigrantë, emigrantët e rikthyer, familjet e policëve të rënë në detyrë. Marrëveshja, përveç sistemit të pikëzimit, për kategoritë e sipërpërmendura, përfshin edhe angazhimin për mbulimin e shpenzimeve, sipas pikës 2 të nenit 24 të këtij ligji.

4. Në objektet e reja që ndërtohen, organet e qeverisjes vendore, në përzgjedhjen e përfituesve marrin parasysh si kriter edhe përzierjen e grupeve të ndryshme sociale, me qëllim që të shmanget veçimi social.”.

## Neni 7

Pas nenit 5 shtohet neni 5/1 me këtë përmbajtje:

### “Neni 5/1 **Transparenca**

Organet e njësjive të qeverisjes vendore duhet të sigurojnë:

1. Informacion të plotë, të lehtë për t'u gjetur, të kuptueshëm dhe të lexueshëm, edhe nga persona me mungesë shikimi. Informacioni duhet të përmbajë:

- a) llojin e programit social të strehimit që zbatohet në atë njësi të qeverisjes vendore;
- b) kushtet që duhet të plotësojnë subjektet e interesuara për t'u përfshirë në programin specifik të strehimit;
- c) dokumentacionin që kërkohet për verifikimin e të dhënave që deklarohet subjekti i interesuar;
- ç) procedurën që do të ndiqet nga njësia e qeverisjes vendore për miratimin e përfituesve;
- d) organin ankimor, të cilit duhet t'i drejtohet subjekti që nuk është përzgjedhur si fitues, afatet kohore dhe formatin e ankimit.

2. Transparençë në procesin e përzgjedhjes së përfituesve, nëpërmjet publikimit të sistemit të pikëzimit dhe vënies në dispozicion, për të interesuarit që nuk janë përzgjedhur, të tabelës përmbledhëse të pikëzimit të të gjithë aplikantëve.

3. Ndihmë për plotësimin e formularëve të aplikimit për strehim për personat me mungesë shikimi, për ata që nuk kuptojnë gjuhën shqipe apo ata që nuk dinë shkrim e këndim, si dhe të sigurojnë që edhe grupe a individë, që kanë vështirësi komunikimi, për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore apo sociale, të marrin informacionin e nevojshëm për këtë qëllim.”.

## Neni 8

Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

### “Neni 6 **Përcaktimi i kufijve të të ardhurave**

1. Jo më pak se 80 për qind e familjeve që trajtohen në banesa sociale me qira duhet të kenë të ardhura deri 100 për qind të të ardhurave mesatare familjare të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse.

2. Pjesa tjetër mund të përzgjidhet brenda intervalit 100 – 120 për qind të nivelit të të ardhurave mesatare. Kjo kategori paguan një qira më të lartë se kategoritë e tjera, por jo më shumë se 30 për qind të të ardhurave mujore.

3. Për vitin e parë të zbatimit dhe në mungesë të të dhënave, sipas pikës 2 të këtij neni, merret për bazë niveli i të ardhurave mesatare të disponueshme dhe të indeksuara me ndryshimin e nivelit të pagave.”.

## Neni 9

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

### “Neni 9 **Administrimi dhe mirëmbajtja e banesave sociale me qira**

1. Me administrim kuptohen të gjitha veprimet dhe vendimet që merren për pronën, ndër të tjera:

- a) vjelja e qirasë;



- b) evidenca e të ardhurave dhe shpenzimeve;
  - c) planifikimi financiar;
  - ç) mbajtja e bilancit;
  - d) ndjekja dhe mbikëqyrja e zbatimit të detyrimeve e të drejtave të palëve kontraktuese.
2. Me mirëmbajtje kuptohen tërësia e veprimeve dhe investimet e nevojshme për punime të zakonshme dhe riparime kapitale për përmirësimin e pronës.
3. Mënyra e administrimit dhe e mirëmbajtjes së banesave sociale me qira përcaktohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore. Banesat me qira, si rregull, administrohen në bazë të një kontrate me entet menaxhuese, të cilat janë persona juridikë, publikë ose privatë, ose persona fizikë, të regjistruar në njërën prej formave të përcaktuara, sipas ligjit që rregullon regjistrimin e personave juridikë.
4. Njësitë e qeverisjes vendore, të cilat kanë një numër të kufizuar banesash sociale për të menaxhuar, mund të ngarkojnë punonjës të njësisë së qeverisjes vendore për administrimin.
5. Enti menaxhues regjistrohet në njësinë e qeverisjes vendore, sipas kritereve që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Enti menaxhues duhet të ketë në përbërje personel të specializuar në fushat e mëposhtme:
- a) juridike;
  - b) sociale;
  - c) financiare;
  - ç) ndërtimore.”.

#### Neni 10

Pas nenit 9 shtohen nenet 9/1 dhe 9/2 me këtë përmbajtje:

##### “Neni 9/1

##### **Kontraktimi i entit menaxhues**

Kontrata me entin menaxhues është e vlefshme, kur kryetari i njësisë së qeverisjes vendore ka kryer një procedurë prokurimi për shërbimin, sipas kuadrit ligjor përkatës. Kontrata me entin menaxhues emërtohet si “Kontratë shërbimi që ka për objekt menaxhimin e banesave sociale”.

##### Neni 9/2

##### **Standardet e menaxhimit të banesave sociale me qira**

Çdo organ i qeverisjes vendore duhet të sigurojë që menaxhimi i banesave sociale bëhet në përputhje me standardet e mëposhtme:

1. Angazhimin dhe fuqizimin e qiramarrësve, duke siguruar:
  - a) trajtimin e të gjithë qiramarrësve në mënyrë të barabartë;
  - b) informimin e duhur për qiramarrësit për llojin dhe standardin e shërbimeve që ata mund të presin nga enti menaxhues, si dhe çdo informacion tjetër që ka lidhje me menaxhimin e banesave;
  - c) forma të qarta dhe të thjeshta për paraqitjen e ankesave dhe që sigurojnë zgjidhjen e shpejtë, të drejtë dhe të kujdesshme për ta;
  - ç) mundësi të ndryshme për qiramarrësit që të angazhohen në menaxhimin e banesave të tyre;
  - d) format dhe mënyrat që qiramarrësit të kontrollojnë dhe të sigurojnë zbatimin e standardeve të menaxhimit.
2. Kushte të përshtatshme të banimit, duke siguruar:
  - a) që banesa e qiramarrësit të jetë në përputhje me standardet e ndërtimit;
  - b) që mirëmbajtja e banesave të jetë e tillë që të sigurojë, së paku, standardet, në bazë të të cilave ajo është ndërtuar ose blerë;
  - c) të gjitha standardet për sigurinë dhe kushtet higjieno-shëndetësore të banesave.

3. Fqinjësinë e mirë, duke siguruar:

a) informacionin e mjaftueshëm për qiramarrësit, për të drejtat dhe detyrimet e tyre për marrëdhëniet e fqinjësisë, respektimin e privatësisë, ruajtjen e qetësisë e të pastërtisë, shmangien e sjelljeve e të veprimeve ofenduese, keqdashëse apo të atyre kriminale;

b) veprim të menjëhershëm ndaj veprimeve që shqetësojnë ose vënë në rrezik shëndetin dhe sigurinë e banorëve.

4. Qëndrueshmërinë dhe transparencën financiare, duke siguruar, ndër të tjera:

a) transparencën në përcaktimin e qirasë për çdo qiramarrës;

b) mbledhjen e qirave në kohë dhe evidentimin e çdo shkeljeje të këtij afati;

c) menaxhimin e rasteve të debitorëve, duke evidentuar shkaqet dhe duke propozuar zgjidhjet e duhura;

ç) auditin e brendshëm dhe kontrollin financiar nga strukturat përkatëse shtetërore dhe vendore.”.

#### Neni 11

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, fjalët “entit menaxhues” dhe fjala “familjes” zëvendësohen, përkatësisht, me fjalët “kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore ose personit të autorizuar prej tij” dhe fjalën “kryefamiljarit”.

2. Fjalja e fundit e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

“Afati i njoftimit për lirimin e banesës përcaktohet në dispozitat e kontratës.”.

#### Neni 12

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 12

#### **Zgjidhja e kontratës së qirasë**

1. Kontrata e qiramarrjes zgjidhet kur:

a) qiramarrësi bën deklaram të rremë për të ardhurat;

b) qiramarrësi ka përfituar një banesë tjetër;

c) qiramarrësi ia ka lënë me qira një të treti;

ç) qiramarrësi, pa arsye të justifikuar, nuk ka paguar qiranë për 3 muaj rresht. Sipas këtij ligji, termi “arsye të justifikuar” nënkupton raste të tilla, si sëmundje e rëndë e papritur, që bëhet shkak për rritjen e shpenzimeve, papunësi e papritur apo humbja e një pjesëtari të familjes që siguronte të ardhurat;

d) të ardhurat e qiramarrësit tejkalojnë ato të përcaktuara në pikën 1 të nenit 6 të këtij ligji.

2. Pas zgjidhjes së kontratës, qiramarrësi është i detyruar të bëjë lirimin e banesës. Në të kundërt, enti menaxhues njofton autoritetet e policisë së njësisë së qeverisjes vendore, të cilat janë të detyruara të realizojnë lirimin e banesës.

#### Neni 13

Pas nenit 12 shtohen nenet 12/1 dhe 12/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 12/1

#### **Pronësia e banesave sociale me qira**

1. Banerat sociale me qira regjistrohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, përveç rasteve kur në marrëveshjet e financimit është caktuar ndryshe.



2. Kur banesat sociale me qira financohen, pjesërisht ose tërësisht, nga Buxheti i Shtetit, ato regjistrohen në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pronave, në emër të njësisë së qeverisjes vendore dhe me barrë hipotekore, që pengon privatizimin e tyre.

3. Trualli, mbi të cilin janë ndërtuar banesat sociale me qira, përjashtohet nga taksa mbi truallin shtetëror në përdorim.

#### Neni 12/2 **Qiraja financiare**

1. Kontrata e qirasë financiare, sipas kuptimit të nenit 849 të Kodit Civil, lidhet ndërmjet qiradhënësit, i cili është pronari i banesës sociale me qira, dhe qiramarrësit, për një afat jo më të vogël se 20 vjet.

2. Gjatë periudhës së qiramarrjes, qiramarrësi është i detyruar të paguajë në mënyrë periodike vlerën e qirasë, të përcaktuar sipas nenit 11 të këtij ligji.

3. Qiramarrësit i lind e drejta për të fituar pronësinë e banesës, në mbarim të afatit të përcaktuar në kontratën e qirasë.

4. Kalimi i pronësisë bëhet me miratim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, përkundrejt shlyerjes së vlerës që përcaktohet, rast pas rasti, dhe duke pasur parasysh masën e vlerës së investimit dhe menaxhimit që ka paguar qiramarrësi. Kur financimi i banesave sociale është bërë me fonde buxhetore, shlyerja e investimit llogaritet për 25 vjet.

5. Kur banesat sociale me qira janë financuar, pjesërisht a tërësisht, nga Buxheti i Shtetit, privatizimi i banesave bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, i cili përcakton kriteret, procedurat dhe vlerën e privatizimit.”.

#### Neni 14

Në nenin 13 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Fjalja e parë ndryshohet si më poshtë:

“Njësitë e qeverisjes vendore, me miratim të këshillave të njësisë të qeverisjes vendore përkatëse, i japin familjes që përfiton nga banesat sociale me qira, e cila plotëson kushtet e përcaktuara në nenet 4 e 5 të këtij ligji, bonus strehimi kur:”.

2. Shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:

“ç) banesa sociale me qira është siguruar me financim nga persona juridikë privatë dhe qiraja është përcaktuar sipas pikës 4 të nenit 11 të këtij ligji.”.

3. Pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) kur familja ka ngelur e pastrehë, si rezultat i një fatkeqësie natyrore ose për shkak të ekzekutimit të vendimit të përmbarrimit apo kthimit të detyruar të shtetasit shqiptar që ka qenë me qëndrim të parregullt në një vend të huaj ose azilkërkues.”.

#### Neni 15

Në nenin 14, pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Këshilli i Ministrave miraton procedurat, kriteret dhe përparësitë e dhënies së bonusit të strehimit, nëpërmjet Buxhetit të Shtetit, për kategori të përcaktuara në pikën 2 të nenit 24 të këtij ligji.”.

#### Neni 16

Në nenin 16 pika 1, fjalët “lëshimit të bonusit” zëvendësohen me fjalët “miratimit të bonusit”.

#### Neni 17

Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 19

**Përcaktimi i nivelit të të ardhurave të familjeve që përfitojnë banesë me kosto të ulët**

1. Përzgjidhet për t’u trajtuar me banesë me kosto të ulët, familja me të ardhurat maksimale mujore jo më të larta se 120 për qind e të ardhurave mesatare, të përcaktuara për prefekturën.

2. Kur banesa me kosto të ulët sigurohet përmes blerjes nga tregu, nëpërmjet një kredie hipotekore nga bankat e nivelit të dytë, me interesa të lehtësuara nga shteti, niveli maksimal i të ardhurave llogaritet nga ministria që mbulon fushën e strehimit, bazuar në vlerat mesatare të shitblerjes së banesave në treg për çdo qytet, normat e strehimit, kushtet e kreditimit nga bankat e nivelit të dytë dhe treguesin e aftësisë paguese jo më shumë se 30 për qind.”.

Neni 18

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 24

**Subvencionimi i qirasë**

1. Kur qiraja e banesës sociale zë më shumë se 25 për qind të të ardhurave neto të familjes, sipas shkronjës “a” të nenit 5 të këtij ligji, kjo e fundit përfiton subvencionim të qirasë. Shuma e subvencionimit llogaritet e barabartë me diferencën ndërmjet qirasë së synuar dhe asaj të përballueshme. Masa e subvencionimit miratohet me vendim të Këshillit të njësisë së qeverisjes vendore.

2. Përparësi në subvencionimin e qirasë ose përfitimin e bonusit të strehimit kanë kategoritë e mëposhtme:

- a) personat me statusin e jetimit;
- b) personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave për këto kategori;
- c) familjet e policëve të rënë në detyrë;
- ç) emigrantët e rikthyer;
- d) punëtori emigrant;
- dh) familjet e komunitetit rom;
- e) punonjësit e Policisë së Shtetit.”.

Neni 19

Pas nenit 25 shtohen nenet 25/1 dhe 25/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 25/1

**Granti i menjëhershëm për banesat me kosto të ulët**

1. Përfitojnë grant të menjëhershëm familjet që plotësojnë kushtin e përcaktuar në pikën 1 të nenit 18 të këtij ligji, të cilat kanë në përbërje:

- a) një person me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave për këto kategori;
- b) një person me statusin e jetimit, i cili në momentin e aplikimit nuk ka mbushur moshën 30 vjeç.

2. Shuma e grantit të menjëhershëm të mos jetë më e madhe se 10 për qind e vlerës së banesës që përfiton personi.

3. Granti i menjëhershëm akordohet nga Buxheti i Shtetit, sipas procedurave, kritereve dhe përparësive që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.



Neni 25/2  
**Grantet e vogla**

1. Buxheti i Shtetit ndihmon me grante të vogla organet e qeverisjes vendore, për zbatimin e projekteve që synojnë përmirësimin e kushteve të banimit të komunitetit rom.
2. Kriteret dhe procedurat e përfitimit dhe të dhënies së granteve të vogla përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon strehimin, sa herë planifikohen fonde.”.

Neni 20

Neni 32 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 32  
**Kushtet për përfitimin e fondeve nga Buxheti i Shtetit**

1. Organi i qeverisjes vendore përfiton nga fondet e investimeve të Buxhetit të Shtetit për ndërtimin e banesave sociale dhe/ose atyre me kosto të ulët kur:
  - a) ka ngritur strukturën përgjegjëse për menaxhimin e strehimit ose ka përcaktuar përgjegjësitë në një nga strukturat ekzistuese;
  - b) ka hartuar planin 10-vjeçar të strehimit;
  - c) ka parashikuar zonat e ndërtimit të banesave në instrumentin vendor të planifikimit urban;
  - ç) ka dërguar informacionin vjetor me të dhënat, sipas shkronjës “ç” të nenit 35 të këtij ligji.
2. Aplikimi për fonde strehimi sipas këtij ligji miratohet me udhëzim të ministrit që mbulon strehimin.”.

Neni 21

Në nenin 39/1 bëhen shtesat si më poshtë:

- a) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Banesat e ish-pronarëve, të zëna nga qytetarët, të cilët janë përfitues të kredisë me interes 0 për qind, lirohen nga organet e njësisë së qeverisjes vendore brenda 30 ditëve nga data e lëvrimit të kredisë, përveç rasteve kur ka marrëveshje noteriale me pronarin/pronarët, nëse familja nuk liron banesën vullnetarisht.”.
- b) Pas pikës 3 shtohen pikat 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

“4. Banesat dhe objektet e kthyer në fond banese me vendime të organeve të qeverisjes vendore, të cilat kanë kaluar në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, si dhe ato që figurojnë ende në pronësi të shtetit, ku, me autorizime të dhëna nga organet kompetente, janë sistemuar me strehim banorë përpara daljes së këtij ligji, mund të privatizohen në favor të banorëve, sipas listës me autorizimet përkatëse dhe sipas procedurave që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Banesat e ndërtuara për familjet e shpërngulura, për shkak të ndërtimit të veprave publike, të tilla si Hidrocentrali i Banjës, Hidrocentrali i Fierzës, Ujëmbledhësi i Bovillës e të ngjashme me këto, të cilat ende figurojnë të paprivatizuara, privatizohen falas me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse dhe sipas listës emërore që kanë trashëguar. Familjet, emrat e të cilave nuk figurojnë në listat e trashëguara, të miratuara nga njësitë e qeverisjes vendore, nuk përfitojnë nga privatizimi falas, por trajtohen sipas pikës 4 të këtij neni.”.

Neni 22

Në të gjithë ligjin:

- a) fjala “bashki” zëvendësohet me fjalët “njësi e qeverisjes vendore”;

b) fjalët “zyra përkatëse në bashki” zëvendësohen me fjalët “struktura përkatëse në njësitë e qeverisjes vendore”;

c) fjalët “këshill bashkiak” zëvendësohen me fjalët “këshill i njësisë së qeverisjes vendore”; dhe

ç) fjalët “kryetar i bashkisë” zëvendësohet me fjalët “kryetar i njësisë së qeverisjes vendore”.

Neni 23

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 10.5.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7494, datë 24.5.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**LIGJ  
Nr. 55/2012**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9235, DATË 29.7.2004 “PËR  
KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 3, pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. “Standarde ndërkombëtare të vlerësimit” nënkupton standardet e miratuara nga Shoqata Ndërkombëtare e Vlerësuesve të Pasurive të Paluajtshme.”.

Neni 2

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

**“Neni 13  
Vlerësimi i pronës**

1. Vlera e pronës që kompensohet nxirret bazuar në çmimin e tregut, llojin e pasurisë dhe qëllimin e përdorimit të saj, sipas standardeve ndërkombëtare të vlerësimit të pasurisë së paluajtshme.

2. Procesit të vlerësimit të pronës, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij neni, i nënshtrohen:

a) toka;

b) objektet ndërtimore.

Në kategorinë e tokës përfshihen toka bujqësore, toka pyjore, pyjet, livadhet dhe kullotat, tokat e pafrytshme, si dhe trualli, pavarësisht masës dhe qëllimit publik apo privat të përdorimit të tij.





Në kategorinë e objekteve ndërtimore përfshihen ndërtesat dhe strukturat inxhinierike, që e gëzojnë këtë cilësi sipas legjislacionit në fuqi.

Treguesit bazë të vlerës së pronës caktohen të veçanta për tokën dhe objektet ndërtimore. Kur një pronë është bashkim i tokës me objektin ndërtimor, vlera e saj nxirret për njësi, si shumë e vlerave të objektit ndërtimor dhe të tokës mbi të cilën ai ngrihet.

3. Metodologjia për vlerësimin e pronës, sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Baza e të dhënave shtetërore të vlerësimit të pasurive të paluajtshme krijohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në të cilin përcaktohen:

- a) institucioni administrues i bazës së të dhënave shtetërore;
- b) të dhënat parësore dhe dytësore;
- c) dhënësin/dhënësit e informacionit;
- ç) ndërveprimi me bazat e tjera të të dhënave;
- d) niveli i aksesimit për subjektet e interesuara.”.

#### Neni 3

Në nenin 24 data “31.12.2011” zëvendësohet me datën “30.4.2014”.

#### Neni 4

Në nenin 28 data “31.12.2011” zëvendësohet me datën “30.4.2014”.

#### Neni 5

Pas nenit 28/3 shtohet neni 28/4 me këtë përmbajtje:

#### “Neni 28/4

#### **Koordinimi i procesit të kthimit dhe kompensimit të pronës**

1. Ministria e Drejtësisë, në funksion të procesit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronës, bashkërendon veprimtaritë e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencisë së Legalizimit dhe Urbanizimit të Zonave dhe Ndërtimeve Informale, Drejtorisë së Administrimit të Shitjes së Pronës Publike, Komisionit Qeveritar të Tokës, Avokaturës së Shtetit, si dhe të çdo institucioni tjetër, veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi mbi këtë proces. Çdo institucion shtetëror, veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi mbi procesin e njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronës, është i detyruar të bashkëpunojë dhe të sigurojë informacionin apo dokumentacionin e kërkuar nga Ministria e Drejtësisë, si dhe të raportojë arsyet e mospërmbushjes së një mase apo rekomandimi të kërkuar.

2. Ministria e Drejtësisë i ushtron këto përgjegjësi nëpërmjet Drejtorisë së Koordinimit, e cila:

- a) përgatit rekomandime për masat ligjore dhe organizative mbi çështjet e të drejtave të pronësisë, duke mbikëqyrur procesin e njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave, si dhe procesin e zbatimit të masave strategjike të miratuara;
- b) harton programe, analiza tekniko-ligjore, studime për efektivitetin dhe ndërmarrjen e masave të nevojshme ligjore dhe ekzekutive për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë;
- c) mbështet, bashkëpunon dhe bashkërendon punët e saj me institucionet e tjera shtetërore, të përfshira në procesin e njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave;
- ç) kujdeset për grumbullimin, përpunimin dhe transmetimin e ndërsjellë të informacionit dhe dokumentacionit midis institucioneve të tjera shtetërore për përditësimin e të dhënave të tyre në funksion të procesit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronës;
- d) ndjek dhe realizon çdo detyrë tjetër të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore.

3. Këshilli i Ministrave, me vendim, cakton rregulla të hollësishme për procedurën e bashkëpunimit dhe të bashkërendimit të veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë me institucionet e tjera shtetërore.

4. Struktura dhe organika e Drejtorisë së Koordinimit është pjesë e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Drejtësisë, që miratohet nga Kryeministri, me propozim të Ministrit të Drejtësisë. Rregulla të hollësishme për ushtrimin e veprimtarive nga Drejtoria e Koordinimit përcaktohen në rregulloren e brendshme të Ministrisë së Drejtësisë.”.

#### Neni 6

#### **Dispozitë kalimtare**

1. Çdo dispozitë ligjore dhe çdo vendim në zbatim të saj, që rregullon vlerësimin e pronës që i kompensohet subjekteve të shpronësuara, shfuqizohet.

2. Vlerësimi i pronës që i kompensohet subjekteve të shpronësuara, deri në miratimin e akteve nënligjore për vlerësimin e pronës, sipas këtij ligji, rregullohet sipas dispozitave të mëparshme.

3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

#### Neni 7

#### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 10.5.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7495, datë 24.5.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

#### **REZOLUTË**

#### **PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE PËR VITIN 2011**

#### **Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,**

- Duke njohur e vlerësuar rolin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për mbikëqyrjen e tregjeve financiare jobankare në Republikën e Shqipërisë;

- Duke vlerësuar kontributin e tij në drejtim të nxitjes së qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së këtyre tregjeve;

- Duke vlerësuar rolin e këtij Autoriteti për t'i siguruar Kuvendit, drejtuesve të institucioneve shtetërore dhe publikut në përgjithësi një informacion cilësor e profesional mbi këto tregje;

- Duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë Autoritet, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e tij me institucionet kombëtare e ndërkombëtare;

#### **Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në drejtim të:**

- Rritjes dhe konsolidimit të pozicionit të Autoritetit në rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve financiare jobankare dhe përballimit me sukses të sfidave të zhvillimit të tyre;

- Konsolidimit të një veprimtarie pune disavjeçare me produkte konkrete në fushën rregullatore, mbikëqyrëse, të teknologjisë së informacionit, atë kooperuese e konsolidimit institucional;



- Përmirësimin të vazhdueshëm të kuadrit rregullator mbikëqyrës, në përputhje me parimet ndërkombëtare dhe direktivat europiane, ndërmarrjes së politikave zhvilluese për tregun, trajnimin të burimeve njerëzore drejt një mbikëqyrjeje efektive etj.

- Mbrojtjes së interesave të konsumatorëve dhe investitorëve, duke garantuar, në të njëjtën kohë, edhe sigurinë e operatorëve të mbikëqyrur;

- Përdorimit të elementëve të rinj të modelit të mbikëqyrjes me bazë risku, e mbështetur nga platforma elektronike e raportimit AMF In-Reg, të cilët ndihmojnë në analizimin e gjendjes financiare dhe treguesve të operatorëve financiarë;

- Përmirësimin në infrastrukturë, për sa i përket krijimit të rrjetit, këmbimit të informacionit dhe mbikëqyrjes elektronike nga Autoriteti kundrejt operatorëve në tregun financiar jobankar;

- Përmirësimin të punës së Autoritetit në veçanti, për sa i takon aktivitetin licencues, ku vlen të theksohet licencimi i shoqërive të para administruese të fondeve të pensionit dhe investimit, i cili ka ndikuar edhe në rritjen e investimeve të huaja direkte në tregjet e sigurimeve;

- Forcimit të bashkëpunimit me institucionet homologe në rajon dhe institucionet brenda vendit, siç është dhe investimi në ndërtimin e sistemit të shkëmbimit të të dhënave në mënyrë automatike me Ministrinë e Brendshme dhe me Ministrinë e Transportit, Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, paraprirë nga nënshkrimi i marrëveshjeve tepër të rëndësishme të bashkëpunimit me këto institucione.

**Kuvendi kërkon që Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2012 të përmirësojë punën në këto drejtime:**

- Plotësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor e në veçanti atij nënligjor në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i marrëveshjes së stabilizim-asociimit, direktivat e BE-së dhe praktikat e vendeve të veçanta europiane;

- Marrjen e masave teknike dhe organizative, me synim përmirësimin e raportit dëme/prime dhe raportit të shpenzimeve, si sfida në drejtim të rritjes së besimit të konsumatorit dhe përmirësimin të shërbimit;

- Nxitjen e fushatave edukuese për publikun, që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit për përfitimet nga produktet dhe shërbimet financiare, në funksion të rritjes së efektivitetit dhe integritetit të tregjeve;

- Krijimin e hapësirave të nevojshme, që lehtësojnë hyrjen e investitorëve dhe kapitalit të huaj në tregjet financiare jobankare.

10 maj 2012

KRYETARE  
Jozefina Topalli (Çoba)

**REZOLUTË  
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ENTIT RREGULLATOR  
TË ENERGJISË (ERE) PËR VITIN 2011**

**Kuvendi i Shqipërisë,**

- Duke vlerësuar rolin aktiv të Entit Rregullator të Energjisë, si autoriteti i vetëm dhe i pavarur rregullator në vend për mbikëqyrjen e funksionimit të tregut të energjisë elektrike dhe të gazit natyror;

- Duke vlerësuar arritjen tashmë disavjeçare të Qeverisë për furnizimin pa ndërprerje të konsumatorëve me energji elektrike;

- Duke njohur rëndësinë e shfrytëzimit optimal të rezervës hidroenergjetike, si dhe faktin që viti 2011 ishte një vit me prurje ujore të ulëta;
- Duke njohur rëndësinë e përmirësimit të efikasitetit të energjisë, si dhe qëndrueshmërisë financiare të sektorit elektroenergjetik;
- Duke konsideruar rëndësinë që ka liberalizimi i tregut të furnizimit me pakicë të energjisë elektrike;
- Duke pasur parasysh faktin që ky vit ishte i rëndësishëm, në kuadër të angazhimeve të vendit në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë për vendet e Europës Juglindore, lidhur me liberalizimin e kapaciteteve të energjisë elektrike;
- Duke vlerësuar si shumë të rëndësishme punën për realizimin e mundësisë së furnizimit të vendit me gaz natyror, nëpërmjet alternativave më të favorshme dhe për përgatitjen e kuartrit rregullator në këtë fushë;
- Duke pasur parasysh rritjen e konsiderueshme të konsumatorëve që i drejtohen ERE-s për zgjidhjen e ankesave të tyre;

**Konstaton se ERE në vitin 2011:**

- Ka vazhduar plotësimin e kuartrit rregullator në sektorin e energjisë, duke pasqyruar angazhimet e marra nga vendi ynë, në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë Elektrike dhe të integritimit evropian, si dhe duke u mbështetur në parimet e konsultimeve publike me grupet e interesit në proceset vendimmarrëse të saj, me qëllim që këto vendimmarrje të balancojnë interesat e shtetit, të konsumatorëve dhe të investitorëve në sektorin e energjisë.
- Ka miratuar, nëpërmjet procedurave transparente dhe gjithëpërfshirëse, kontratën e re të furnizimit me energji elektrike për klientët familjarë dhe jofamiljarë dhe Rregulloren e Cilësisë së Shërbimit të Shpërndarjes dhe Furnizimit me Energji Elektrike, duke plotësuar detyrimin, në përputhje me Deklaratën Rregullatore për miratimin e kushteve të reja të cilësisë së shërbimit të furnizimit me energji elektrike të konsumatorit dhe duke garantuar kërkesat e konsumatorëve tariforë për mbrojtjen e interesave të tyre nga natyra monopol e këtij shërbimi.
- Ka ushtruar në mënyrë të vijueshme autoritetin e tij për monitorimin e të gjithë operatorëve të licencuar në sektorin e energjisë elektrike, në lidhje me mirëfunksionimin e tregut të energjisë elektrike, efikasitetit dhe cilësisë së shërbimit që ata ofrojnë për konsumatorët.
- Ka garantuar mbrojtjen e vazhdueshme të interesave dhe të drejtave të konsumatorëve tariforë, nëpërmjet trajtimit me përkushtim, transparencë, paanshmëri dhe brenda afateve ligjore të ankesave të konsumatorëve.
- Ka punuar në zhvillimin e kapaciteteve të veta institucionale për krijimin e kuartrit të domosdoshëm rregullator në fushën e gazit natyror, të harmonizuar me direktivat e BE-së dhe me vendet e rajonit, duke u fokusuar kryesisht në mbështetjen e gjithanshme të përpjekjeve për konkretizimin e projektit TAP, për të krijuar hapësirat e nevojshme për interesat shqiptarë në të.
- Nëpërmjet një procesi transparent e profesional dhe në përputhje me metodologjitë përkatëse, ka përcaktuar tarifat dhe çmimet për veprimtarinë e prodhimit, furnizimit publik me shumicë, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë të energjisë elektrike për klientët tariforë, sikurse çmimet e shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit e vegjël.
- Me qëllim rritjen e sigurisë së furnizimit në vend dhe në kuadër të një klime promovuese për investimet e reja, ka licencuar 39 subjekte juridike në prodhim energjie, tregtues energjie, furnizues të kualifikuar të energjisë elektrike, si dhe modifikime të licencave ekzistuese.
- Në mënyrë transparente është angazhuar në dhënien e rekomandimeve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve në tregun e energjisë elektrike.
- Në funksion të rritjes së transparencës dhe përmirësimit të shërbimeve të ofruara në sektorin e energjisë, është angazhuar në publikimin e informacionit për kushtet e kryerjes së shërbimeve nga kompanitë e licencuara në sektorin e energjisë.



- Ka konsoliduar akoma më shumë marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë dhe institucionet e tjera shtetërore dhe ka vazhduar të ndjekë një formë bashkëpunimi dhe informimi periodik për zgjidhjen e sfidave të ndeshura në procesin e rregullimit të sektorit të energjisë elektrike.

**Kërkon që ERE për vitin 2012:**

- Të vazhdojë monitorimin e tregut të energjisë elektrike, për të rritur transparencën dhe garantuar mosdiskriminimin, nëpërmjet procesit të hartimit të rregullave dhe rregulloreve, për të nxitur konkurrencën në këtë treg dhe orientimin e tij drejt liberalizimit të mëtejshëm.

- Të punojë për hartimin e rregulloreve për lidhjet e reja në të gjitha hallkat e sistemit të energjisë elektrike, me synimin për shkurtrimin e afateve dhe zbatimin e procedurave transparente për realizimin e furnizimit me energji të bizneseve dhe konsumatorëve familjarë.

- Të rishikojë kodet e transmetimit, të shpërndarjes dhe të matjes së energjisë elektrike, në kuadër të përafrimit të legjislacionit me Paketën e Tretë Rregullatore të Bashkimit Europian.

- Të intensifikojë më tej punën për monitorimin e të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, në mënyrë të veçantë të kompanisë CEZ Shpërndarje, për realizimin e treguesve kryesorë të saj në arritjen e objektivave për reduktimin e humbjeve në rrjet dhe rritjen e arkëtimeve.

- Të angazhohet me përparësi në plotësimin e kuadrit rregullator dhe kryerjen e procedurave të nevojshme për mbështetjen e projekteve me interes kombëtar për gazifikimin e vendit.

- Të vazhdojë të garantojë mbrojtjen e konsumatorëve të energjisë elektrike, nëpërmjet trajtimit me përkushtim të ankesave të konsumatorëve dhe hartimit të standardeve të trajtimit dhe zgjidhjes së ankesave të konsumatorëve nga ana e të licencuarve.

- Të monitorojë cilësinë e shërbimit të ofruar konsumatorëve për të garantuar furnizim të pandërprerë me energji elektrike në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, në përputhje me standardet minimale të cilësisë së shërbimit të energjisë, të miratuara nga ERE.

- Të hartojë rregulloren e procedurave të vendosjes së gjobave për të licencuarit, në rastet e kundërvajtjeve administrative të kryera prej tyre, ku të përcaktohen aspektet e posaçme të kushteve dhe procedurave që duhet të ndiqen nga ana e ERE-s, si dhe shkeljet e detajuara, të cilat përbëjnë shkak për ndëshkimin e tyre.

- Të rishikojë modelin e tregut të energjisë elektrike, duke pasur në konsideratë ndryshimet e fundit në legjislacion dhe kushtet e reja të hapjes së tregut dhe përshtatjes së tij me tregun rajonal.

- Të hartojë rregullat dhe procedurat për trajtimin e shërbimeve ndihmëse në sektorin elektroenergjetik.

17 maj 2012

KRYETARE  
Jozefina Topalli (Çoba)

**URDHËR**  
Nr. 177, datë 4.6.2012

**MBI ZBATIMIN E URDHËRIT NR. 328, DATË 22.11.2011 DHE TË URDHËRIT NR. 5, DATË  
9.1.2012 TË MINISTRIT TË BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË  
KONSUMATORIT MBI CERTIFIKATAT VETERINARE**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 55 të ligjit nr. 10 465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 18 të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”,

**URDHËROJ:**

1. Certifikatat veterinarë të përdorura përpara hyrjes në fuqi të urdhrit nr. 328, datë 22.11.2011 “Për miratimin e rregullores mbi përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për certifikimin veterinar të disa lloje kafshësh dhe mishit të freskët të tyre, të cilat hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga shtete të caktuara, si dhe nga territore të tjera në administrim të këtyre shteteve”, si dhe të urdhrit nr. 5, datë 9.1.2012 “Për përditësimin e certifikatave veterinarë të cilat shoqërojnë ngarkesat e ushqimeve me origjinë shtazore, si dhe ngarkesat e ushqimeve për kafshë prodhuese të ushqimit dhe të cilat hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë”, do të lejohen të shoqërojnë ngarkesat përkatëse që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, nëse janë lëshuar nga autoritetet kompetente jo më vonë se 20 ditë nga dita e notifikimit të urdhrave të lartpërmendur në Organizatën Botërore të Tregtisë, më datë 30.5.2012.

2. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimit Veterinar, Drejtoria e Politikave të Sigurisë Ushqimore dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ky urdhër hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT  
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT  
Genc Ruli**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**  
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 4.6.2012  
Doli nga shtypi më 5.6.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2012

Çmimi 36 lekë